225
29.12.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 29.12.2023**

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 28.12.2023, pas shqyrtimit të dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, sipas vendimit për aprovimin në parim, me vendimin Nr. 148, të datës 04.07.2023, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

## VENDIM

**Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës**

1. Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.

2. Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për mbrojetjen nga dhuna në familje.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planit Lokal të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet:** **Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, Njësisë për DNJBGJ dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Ali Ismaili**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT
# PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE
(2024 - 2026)

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje



Kontaktet:

Policia e Kosovës – Fushë Kosovë

Qendra për Punë Sociale –

Thirrjet emergjente - 112

Zyra për Ndihmë dhe Mbrojtje të Viktimave - 0800 11112

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – 0800 11 777

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve – 038 545 476, 044 420 052

**Falënderim**

Hartimi i Planit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PLVMDHF), ishte përpjekje e përbashkët e Mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje, për hartimin e Planit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, në koordinim me Koordinatoren e Mekanzimit Kundër Dhunës Familje, me përkrahjen e misionit të OSBE-së në Kosovë dhe një spektri të gjerë të partnerëve.

PLVMDHF është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Fushë Kosovës, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Përmbajtja

Hyrje përmbledhëse

Qëllimi dhe objektivat e Planit të veprimit

Plani i veprimit

Plani i monitorimit dhe raportimit

## Hyrje përmbledhëse

Dhuna në familje është vepër penale[1] dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës[2] në kuadër të parimeve të saj, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, që "dhunën në familje"[3] e përkufizon: "veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimën".

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për barazi gjinore (2022 – 2026), që njëherësh paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal.

Duke dënuar të gjitha format[4] e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara *"Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë "*[5], Plani i veprimit është e përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit[6] ( i datës 25 maj 2021 ), karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësive që rrjedhin nga marrëveshja e mirëkuptimit, kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Njëherësh, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e

[1] Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

[2] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

[3] Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare: http://www.assembly- kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf 2;

[4] Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar ne dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

[5] OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

[6] Marrëveshje Mirëkuptimi për Institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe Mënyrën e Funksionimit të të tij , në Komunën _______ më datë _________;

koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqëror, ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

## II Qëllimi dhe objektivat e Planit të veprimit

Ndonëse, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut[7] dhe përbën goditje të dinjitetit njerëzor, si në gjithë globin edhe në shoqërinë kosovare ajo vazhdon të jetë e përhapur me përmasa mjaftë të mëdha.

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave[8] dhe me të drejtë konsiderohet pengesa më e madhe në realizimin e një bote paqësore, të prosperuar dhe të qëndrueshme. Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera, si: papunësia, lëvizjet demografike, ndryshime të koncepteve mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore.

Duke qenë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje gjithnjë e më shumë po njihen jo vetëm si shkelje e të drejtave individuale, por edhe si kërcënim për demokracinë, pengesë për zhvillim shoqëror dhe rrezik për paqe të qëndrueshme, pasojat e së cilës tronditin jo vetëm rrethin e ngushtë të familjes, por të gjithë shoqërinë, dhe si e tillë kërkon angazhim të gjithë shoqërisë për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje,

Para së gjithash, Plani do të ndikoj në rritjen e bashkëpunimit në mes të qytetarit dhe institucioneve shtetërore, shtyllat e së cilës janë të vendosura në "parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave të saj dhe ndjekjen penale të dhunuesve". Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve, duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje.

Plani lokal i veprimit kundër dhunës në familje për Komunën e Fushë Kosovës, synon:

□ të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;

□ të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të aktorëve relevantë;

□ të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;

□ të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave, si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

---

7 Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994; https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstËomen.aspx, qasur më 1 korrik 2021;

8 Këshilli i Europës, Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, preambula, 2011;

Mbështetur në tri fusha të veprimit, si *"Vetëdijësimi dhe parandalimi"*; *"Mbrojtja dhe koordinimi"*; *"Fuqizimi ekonomik, rehabilitimi dhe riintegrimi"* me anë të adresimit të objektivave strategjike dhe specifike, si:

**Objektiva Strategjike #1**: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje:

**Objektiva specifike #1.1**: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

**Objektiva specifike #1.2**: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

**Objektiva strategjike # 2**: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje:

**Objektiva specifike # 2.1**: Funksionalizimi i Mekanizmit koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike # 2.2**: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike # 2.3**: Avancimi i monitorimi të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike # 2.4**: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në familje;

**Objektiva Strategjike # 3**: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje:

**Objektiva specifike # 3.1**: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje;

**Objektiva specifike #3.2**: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në Familje.

Plani i veprimit 2024-2026

| Nr. | Objektivat strategjike specifike, treguesit dhe veprimet | | Vlera baze | Objektivi i përkohshëm [2024] | i vitit të fundit [2026] | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I. | Objektivi strategjik: Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** % e mekanizmave institucionalë kanë njohurit e duhura për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje. | | 30 % | 50 % | 70 % | Promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave dhe marrja e masave të nevojshme për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje. |
| 2 | **Treguesi:** % e popullsisë kanë njohuritë e duhura për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje | | 25% | 35% | 50% | Qytetarët e komunës së Fushë Kosovës kanë njohuritë e duhura për rolin dhe përgjegjësinë qytetare për mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut dhe parandalim të dhunës në familje |
| I.1 | Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** Nr. i profesionistëve kanë njohuritë e duhura për standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës në familje | | 30 % | 50 % | 70% | Parimet dhe standardet ndërkombëtare për parandalim dhe luftim të dhunës në familje, janë pjesë integrale në përditshmërinë e mekanizmave relevantë. |
| 2 | **Treguesi:** Nr. i profesionistëve kanë njohuritë e duhura për obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore vendore për parandalim dhe luftim të dhunës në familje | | 30% | 50% | 70% | Prioritizimi dhe rritja e efikasitetit të trajtimit të rasteve për parandalim dhe luftim të dhunës në familje |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | | Buxheti 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1 | Realizimi i sesioneve informuese për Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, ngritja e kapaciteteve të profesionistëve institucionalë për Konventën e Këshillit të Evropës; Ligjin Kundër dhunës në familje; bashkërendimin e rasteve për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje. | 2024 -2026 | | 2000 euro | 1500 euro | 1500 euri | Komuna Donatorët | Komuna ZBGJ, PK, QPS, MV, ZDJF, | -2 takime me përfaqësuesit institucionalë të nivelit lokal kanë njohuritë e duhura për Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë;<br>-1 takim me profesionistët institucionalë kanë njohurit e duhura për Konventën e Këshillit;<br>- 1 takim; Profesionistët institucionalë kanë njohuritë e duhura për Ligjin kundër dhunës në familje;<br>- 6 sesione informuese brenda vitit për bashkërendim të rasteve | Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë; Konventën e Këshillit të Evropës; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| I.1.2 | Punësimi i psikologut/pedagogut në çdo shkollë | 2024-2026 | | Target i arrihet 2024 / 26 | | | Komuna | Komuna DKA | Në vitin 2024 do të përfshihen 3 -5 psikokologë/e shkollore dhe | Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021; |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | psikolog/e | | | | | Në vitin 2024 do shtohen edhe 3 -6 psikologë/e;<br>-Shkolla ka kuadrin profesional për parandalim, trajtim dhe raportim të rasteve të dhunës ndaj vajzave dhe dhunës në familje | Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| I.1.3 | Ngritja e njohurive të mësimdhënësve në identifikimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në familje | 2024-2025 | | 3000 euro (OJQ-ve pjese e grupit | 2000 euro (OJQ | | Komuna Donatorët/ OJQ (pjesë e grupit) | Komuna DKA | 150 mësimdhënës/e për periudhën 2024/2025 - Mekanizmat e shkollës kanë njohurit e duhura për parandalimin, identifikimin dhe raportimin e rasteve te dhunës në familje; | Ligji për Arsimin Parauniversitar;<br>Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;<br>Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026; |
| I.1.4 | Vizitë studimore lidhur me funksionimin e mekanizmit koordinues në trajtimin e rasteve të dhunës në familje | 2024-2026 | | Vizitë studimore jashtë vendit | | | Komuna Donatorët | Komuna | Rritja e njohurive mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas standardeve ndërkombëtare; | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; |
| | ***Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik I.1:*** | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |
| I.2 | Objektivi specifik: Vetëdijesimi i opinionit publik për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje | | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** % e qytetarëve kanë njohuritë e duhura për përgjegjësitë qytetare për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në familje; | | | 20% | 40% | | 60% | Familja është institucion, ku të gjithë anëtarët janë të sigurtë, jetojnë në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi që nxit barazinë në mesin e anëtarëve të saj. | | |
| 2 | **Treguesi:** % e qytetarëve që kanë përfituar nga aktivitetet vetëdijësuese për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje | | | | | | | Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për t'i thënë ndal dhunës në familje. | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | | Buxheti 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
| I.2.1 | Organizimi i fushatës vetëdijësuese për të drejtat e njeriut, me fokus të drejtat e grave; Fushatë vetëdijësuese lidhur me manifestimet e formave të dhunës në familje, pasojat e saj dhe nevojën për të parandaluar dhunën; Shtypja dhe shpërndarja e Konventës së Stambollit. | 2024-2026 | | 2000€ | 1000€ | 1000€ | Komuna Donatorët /OJQ SIT | Komuna ZBGJ | Rritja e njohurive të qytetarëve për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave; Rritja e ndërgjegjësimit dhe perceptimit nga publiku i gjerë lidhur me format e dhunës; Mekanizmat përgjegjës institucionalë njohin masat e vëna në | Ligji për mbrojtje nga diskriminimi; Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | dispozicion të Konventës së Stambollit. | |
| I.2.2 | Realizimi i sesioneve informuese me fëmijë dhe të rinj për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës | 2024 | | 1sesio Ekipi për Mbrojt jen e Fëmije s | 1 Ekipi për Mbrojt jen e femije s | 1. Ekipi për Mbrojtj en e femijes | Komu na Donat orët | Komuna ZBGJ | Fëmijët dhe të rinjtë kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, MV, ZNJF, strehimoret) | Procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje |
| I.2.3 | Realizimi i sesioneve informuese me gra dhe viktima të dhunës në familje për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës | 2024 | | | | | Komu na Donat orët | Komuna ZBGJ | 5 sesione në strehimore me gratë dhe viktimat e dhunës në familje, kanë njohuri të duhura për rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse (si: PK, QPS, MV, ZNJF, strehimoret) | Procedurat standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje |
| I.2.4 | Organizimi i aktiviteteve jo-formale (përmes artit, eseve, ekspozitave, dramave, etj) me fokus parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje | 2024 | | 1000 euro | 1000 euro | 1000 euro | Komu na Donat orët | Komuna ZBGJ | DKA informatë metutje! Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar pabarazitë dhe dhunën në familje; | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për Arsimin Parauniversitar; Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2022-2026; |
| I.2.5 | Informimi i publikut përmes rrjeteve sociale për mbrojtjen që iu ofrohet viktimave të dhunës në | 2026 | | | | | Komu na Donat orët | Komuna ZBGJ | KP- me perdore vetem nje platforme; Opinioni publik ka njohurin e duhur për ekzistencën | Procedurat standarde të veprimit për Mbrojtje nga dhuna |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | familje dhe institucionet përkatëse ku duhet të orientohen. | | | | | | | | dhe rolin e shërbimeve për mbrojtje nga dhuna në familje. | në familje në Kosovë |
| | *Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik I.2:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |
| Nr. | Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet | | Vlera baze | Objektivi i përkohshëm [2023] | | Synimi i vitit të fundit [2026] | Rezultati | | | |
| II. | Objektivi strategjik: Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** Komuna ka zhvilluar politika lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje | | 1 | 5 | | 7 | Parandalimi dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje janë vendosur në agjendën e prioriteteve të qeverisjes lokale | | | |
| II.1 | Objektivi specifik: Funksionalizimi i Mekanizmit koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** Nr. i takimeve të realizuara nga Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje | | 6 | 6 | | 6 | Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje, i fuqizuar sipas TOR | | | |
| 2 | **Treguesi:** Nr. i aktiviteteve të realizuara nga Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje | | 5 | 4 | | 12 | Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional | | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |

| | | | | | | | | mbështet ës | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1. 1 | Hartimi i Rregullores së punës të Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje | 2026 | | | | | Komuna bashkëpunëtore e jashtme | Komuna koordinatore DNJ-BGJ | Rregullorja e punës e Mekanizmit koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje, e aprovuar | Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Marrëveshja e mirëkuptimit për institucionalizimin e Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje; |
| II.1. 2 | Hartimi dhe publikimi i raportit të monitorimit për mbrojtje nga dhuna në familje; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale lidhur me marrjen e masave për parandalim, trajtimin, strehimin dhe mbrojtje të dhunës në familje; Hartimi dhe adresimi i rekomandimeve për qeverisjen lokale | 2024-2026 | | | | | Komuna bashkëpunëtore e jashteme | Komuna Komuna koordinatore DNJ-BGJ | Raporti i monitorimit për mbrojtje nga dhuna në familje, i hartuar nga Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje; Rritja e koordinimit institucional | Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; Marrëveshja e mirëkuptimit për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje; |
| | ***Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik II.1:*** | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |
| II.2 | Objektivi specifik: Fuqizimi i sistemit të raportimit dhe ankesave për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** Nr. i rasteve të raportimit të dhunës në familje | | X | | X | | X | Qytetarët janë inkurajuar të raportojnë rastet e dhunës në familje në institucionet përkatëse | | |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Treguesi: Nr. i ankesave të parashtruara nga viktimat e dhunës në familje | | X | X | X | Viktimat e dhunës në familje përdorin shërbimet e specializuara | | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
| II.2.1 | Identifikimi i rasteve të dhunës në familje nëpërmjet mbledhjes periodike të të dhënave në terren | 2026 | | | | Komuna | Komuna | Rritja e numrit të rasteve të identifikuara në terren nga mekanizmat relevantë; | Ligji për familjen; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Ligji për Policinë; |
| II.2.2 | Vizualizimi i shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas | 2026 | | | | Komuna Donatorët | ZNJF | Rritja e vizibilitetit të mandatit dhe shërbimeve që ofrohen nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas | Ligji për ndihmë juridike falas |
| II.3 | Objektivi specifik: Avancimi i monitorimit të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | |
| 1 | Treguesi: Treguesit për mbrojtjen nga dhuna në familje | | Treguesit e identifikuar | Treguesit e përfshirë në bazë të të dhënave | Baza e të dhënave funksionale | Integrimi i sistemit lokal për mbrojtje nga dhuna në familje | | | |
| 2 | Treguesi: Raporti i monitorimit i publikuar | | | | Raport i vjetor | Vlerësimi i progresit të zbatimit të politikave dhe obligimeve ligjore për mbrojtje nga dhuna në familje | | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti 2024 | 2025 | | Burimi i | Institucioni udhëheqë | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |

| Nr | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti 2024 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.3.1 | Grumbullimi i të dhënave të standardizuara mbi dhunën në familje; Përcaktimi i nevojave, sfidave, përparësive dhe marrja e masave në bazë të analizës së të dhënave për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; Hartimi i raportit vjetor për mbrojtje nga dhuna në familje; Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore | 2024-2026 | | | | Komuna Donatorët | Komuna | Komuna në vazhdimësi gjeneron të dhëna për mbrojtje nga dhuna në familje; Orienton politikat dhe veprimet institucionale bazuar në të dhëna cilësore; Raporti vjetor mbi situatën për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, i publikuar; Zyrtarët institucionalë kanë njohuritë e duhura për mbledhjen, përdorimin dhe analizimin e të dhënave; | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; Marrëveshja e mirëkuptimit për institucionalizimin e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje; |
| II.4 | Objektivi specifik: Fuqizimi ekonomik i grave dhe viktimave të dhunës në familje | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:**Nr. i viktimave të dhunës në familje të punësuara | | X | X | x | Janë fuqizuar ekonomikisht viktimat e dhunës në familje | | | |
| 2 | **Treguesi:**Nr. i politikave komunale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje të aprovuara | | X | X | X | Komuna ka marrë të gjitha masat administrative afirmative për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje | | | |
| Nr | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti 2024 | 2025 | 2026 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |

| | | | | | | | | mbështet ës | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II.4. 1 | Referimi i rasteve për ngritje profesionale në qendrat e aftësimit profesional për viktimat e dhunës në familje | 2026 | | | | | Komu na APRK<br>Donat orët | Komuna | Viktimat e dhunës në familje, profilizohen me profesione të caktuara | Strategjia kombëtare për zhvillim; Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020-2024; Objektivi 5 për zhvillim të qëndrueshëm |
| II.4. 2 | Subvencionimi/përkrahja e projekteve për rehabilitim dhe riintergrim,aftësim të viktimave të dhunës në familje; Ndërmjetësimi për punësim për viktimat e dhunës në familje | 2024 - 2026 | | | | | Komu na Donat orët | Komuna; Zyra e punësimit | 5 projektet zhvillimore/ biznesore të viktimave të dhunës në familje, janë subvencionuar nga Komuna;<br>Rritja e numrit të viktimave të dhunës në familje që janë punësuar | Strategjia kombëtare për zhvillim; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; Objektivi 5 për zhvillim të qëndrueshëm. |

| Nr. | Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet | | Vlera bazë | Objektivi i përkohshëm [2023] | Synimi i vitit të fundit [2025] | Rezultati |
|---|---|---|---|---|---|---|
| III. | Objektivi strategjik: Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimave të dhunë në familje | | | | | |
| 1 | Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese për viktimat e dhunës në familje | | X | X | X | Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve rehabilituese për viktimat e dhunës në familje; |
| 2 | Treguesi: Nr. i shërbimeve riintegruese për viktimat dhunë në familje | | X | X | X | Lehtësimi i qasjes dhe rritja e kualitetit të shërbimeve riintegruese për viktimat e dhunës në familje; |

| III.1 | Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve rehabilituese për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Treguesi: Nr. i shërbimeve rehabilituese të qasshme | | | X | X | X | Është lehtësuar qasja në shërbime rehabilituese, efikase dhe të qëndrueshme, për viktimat e dhunës në familje; | | | |
| 2 | Treguesi: % e bugjetit në dispozicion për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje | | | X | X | X | Komuna alokon buxhet të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje; | | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
| | | | | 2024 | 2025 | 2026 | | | | |
| III.1.1 | Ofrimi i strehimit social për viktimat e dhunës në familje | 2026 | | | | | Komuna Donatorët | Komuna | Viktimave të dhunës në familje iu ofrohet strehim; | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| III.1.2 | Ndarja e buxhetit për ofrimin e shërbimeve emergjente për viktimat e dhunës në familje | 2026 | | 500 | 1000 | 1000 | Komuna Donatorët | Komuna | Shërbimet emergjente të bugjetuara dhe në dispozicion 24/7 për viktimat e dhunës në familje; | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; |
| III.1.3 | | 2026 | | | x | 300 000 | Komuna Donatorët | Komuna | Kryerësve të dhunës në familje iu ofrohen shërbime rehabilituese profesionale | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ngritja e qendrës për rehabilitim të kryerësve të dhunës në familje | | | x | | | | | | dhunës në familje; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| III.1. 4 | Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje | 2026 | | 10 000 | 10 000 | 10 000 | Komu na Donat orët ANJF | Komuna | QPS: Viktimave dhe kryerësit të dhunës në familje iu ofrohen shërbime profesionale psiko-sociale. | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| III.1. 5 | Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe këshilluese për ruajtjen e shëndetit mendore për viktimat e dhunës në familje | 2026 | | | | | Komu na Donat orët QSH M QMF | Komuna | Viktimave të dhunës në familje iu ofrohen shërbime profesionale për ruajtjen e shëndetit mendor. | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| | ***Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik III.1:*** | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |
| III.2 | Objektivi specifik: Avancimi i shërbimeve riintegruese për mbrojtje nga dhuna në familje | | | | | | | | | |
| 1 | **Treguesi:** Nr. i viktimave të dhunës në familje të punësuar | | | X | X | | X | Fuqizimi i viktiomave të dhunës në familje për jetësë të pavarur | | |

| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | **Treguesi:** Nr. i viktimave të dhunës në familje përfitues të subvencioneve nga Komuna | | X | | X | | X | Fuqizimi i viktiomave të dhunës në familje për jetesë të pavarur | | |
| | | | | 2024 | 2025 | 2026 | | | | |
| III.2.1 | Vlerësimi i nevojave të viktimave të dhunës në familje. | 2026 | | | | | Komuna Donatorët | Komuna | Viktimave të dhunës në familje u ofrohet përkrahja e nevojshme sipas nevojave të identifikuara | Konventa e Stambollit; Ligji kundër dhunës në familje; |
| III.2.2 | Sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje. | 2026 | | | | | Komuna Donatorët DMS | Komuna | 120 mbrenda vitit; viktimave të dhunës në familje iu ofrohet strehim i sigurte | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| | ***Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik III.2:*** | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

| 2 | Treguesi: Nr. i viktimave të dhunës në familje përfitues të subvencioneve nga Komuna | | X | | X | | X | Fuqizimi i viktiomave të dhunës në familje për jetesë të pavarur | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Buxheti | | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
| | | | | 2024 | 2025 | 2026 | | | | |
| III.2.1 | Vlerësimi i nevojave të viktimave të dhunës në familje. | 2026 | | | | | Komuna Donatorët | Komuna | Viktimave të dhunës në familje u ofrohet përkrahja e nevojshme sipas nevojave të identifikuara | Konventa e Stambollit; Ligji kundër dhunës në familje; |
| III.2.2 | Sigurimi i strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje. | 2026 | | | | | Komuna Donatorët DMS | Komuna | 120 mbrenda vitit; viktimave të dhunës në familje iu ofrohet strehim i sigurte | Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje; |
| | *Buxheti i përgjithshëm për objektivin specifik III.2:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat kapitale:* | | | | | | | | | |
| | *Nga të cilat rrjedhëse:* | | | | | | | | | |

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

Ali Ismaili

Plani i monitorimit dhe raportimit

Synimi kryesorë i Komunës së Fushë Kosovës pa dyshim se është realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e veprimit.

Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit të planit në baza vjetore.

Koordinatori e Njesitit për Drejtate Njeriut,ZBGJ do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muaj do t'i raportojë direkt Kryetarit të Komunës.

Me ç 'rast, çdo fundvit Mekanizmi koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje është i obliguar të hartojnë Raportin e monitorimit mbi zbatimin, i cili do të jetë treguesi kyç për të pasqyruar qartë progresin, apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e veprimit.

67
06.03.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 138, të datës 15.02.2023, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**
**Për miratimin e Planit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025**

1. Për miratimin e Planit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2023-2025.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani për Barazi Gjinore i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, përgjegjës është Kryetari i Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Njësiti për të Drejtat e Njeriut e Barazi Gjinore dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Ali Ismaili**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.fag/Br.str. 67
Datë/Datum. 06.03.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

# Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2023 – 2025

## Fushë Kosovë

Përmbajtja

Hyrje përmbledhëse ........ 3

Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit........ 4

Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar ........ 5

Metodologjia ........ 5

Parimet kryesore........ 6

Problemet e identifikuara deri tani që kanë shkaktuar pabarazinë gjinore në Komunën e Fushe Kosoves........ 6

Fushat në të cilat ka fokus ky plan veprimi........ 7

Kohëzgjatja e zbatimit të planit te veprimmit dhe institucionet e përfshira........ 8

Aktivitetet për zbatim........ 9

Plani i monitorimit dhe i vleresimit ........ 11

Tabela e veprimeve ........ 12

## *I* Hyrje përmbledhëse

Barazia gjinore është një e drejtë themelore e përcaktuar si një parim fondamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ,barazia gjinore konsiderohet faktorë i rëndësishëm për rritje dhe zhvillim ekonomik, mirëqenje sociale dhe stabilitet.

Arritja e barazisë gjinore e paraparë edhe me Ligjin për Barazi Gjinore nr 05/L-020 kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur cështjet e ndryshme si ato të arsimit ,shëndetit ,shërbimeve sociale punësimit, drejtësisë ,familjes, fëmijëve dhe të moshuarve etj.

Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha nivele të pushtetit ligjëvënës ekzekutiv gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjësëe për të zbatuar masat legjislative si dhe masat tjera duke përfëshirë edhe miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 -2024 , i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me daten 23. maj 2020 nr vendimit 01/34 .

Komuna e Fushë Kosovës si dhe komunat tjera kanë detyrim në zbatimin e këtij programi , prandaj është edhe detyrim që të kenë plane të veprimit në të cilat do të specifikojnë aktivitetet me qëllim të realizimit të objektivave qendrore.

Ky plan veprimi i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor për barazi gjinore në tërsi si dhe akteve tjera nënligjore dhe politikave publike për barazi gjinore .

## II Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit

Gjendja aktuale në Komunën e Fushë Kosovës e ngjajshem me komunat tjera, nuk është e kënaqshme dhe një ndër problemet kryesore është prania e pabarazive gjinore dhe përjashtimi socio- ekonomiko-strukturor. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë problem janë: mungesa e integrimit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore, mos zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor diskriminimi në punësim,ndarja e profesioneve sipas gjinisë dhe sipas kerkesave te tregut , ndarja e pabarabartë e obligimeve për përkujdesjen e fëmijëve dhe të moshuarve, mungesa e institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve dhe qasja e kufizuar në të drejtat pronësore dhe financa.

Probleme tjera të identifikuara janë mos pasja e statistikave gjinore sepse kjo Komune ballafaqohet me nr te madhe te migrimeve dhe fluks te madhe te qytetareve që nuk i takojne kesaj komune dhe në të njejten kohe nuk ka as regjistrimin e tyre,andaj edhe hartimi i politikave gjinore apo tjera behet vetem me nr aktual te qytetareve te regjistruar dhe sherbimet jane shume te mangeta ne krahasim me nr e kerkesave te qytetarëve.
Në këtë komunë ende janë të pranishme stereotipet gjinore mbi ndarjen e punës, pjesëmarrje e ulët e grave në pozita vendimmarrëse dhe ri integrimit të viktimave të dhunës në familje.

*Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe **obligimet që dalin nga ky legjislacion Komuna e Fushë Kosovës do të sigurojë që barazia gjinore do të jetë e garantuar në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të Komunës dhe do të ndërmarrë këtë iniciativ si*** obligimin i dalë nga legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar për arritjen e barazisë gjinore me të cilën synon :

- Krijimin e mundësive të barabarta në pjesëmarrje dhe përfitim ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies sociale;
- Avancimin e barazisë gjinore, dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore;
- Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje dhe qasje ne drejtësi

## III Legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar

Hartimi i Planit **të veprimit për arritjen e barazisë gjinore të Komunës së Fushë Kosovës** është **obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore 05/L -020** specifikisht, Neni 5 , paragrafi 1.2 i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore.

Për më tepër ky ligj në paragrafin 1.3 obligon institucionet të përfshijnë integrimin gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion , sigurimin e barazisë gjinore në proceset e përzgjedhjes dhe caktimit në punë duke përfshirë pozicionet drejtuese duke siguruar përfaqësim të barabartë edhe në konferenca mbledhje dhe trajnime dhe duke siguruar burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe,projekte dhe iniciativa per arritjen e barazise gjinore

Ligji gjithashtu obligon institucionet edhe për mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë dhe shpërndarjen e tyre

Institucionet publike ndërmarrin masa të vecanta të përkohshme me qëllim të arritjes dhe realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në fushat ku ekzistojnë pabarazi .

Ky Plan veprimi është hartuar duke konsideruar instrumentet, kornizën ligjore dhe politikat kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave.

## Metodologjia

Ky plan veprimi është bërë nën udheheqjen e Zyrës për Barazi Gjinore te Komunës së FushëKosovës e cila në bashkëpunim me grupin e grave asambleiste dhe grave tjera të kësaj komune ka krijuar një ekip i cili kishte ne përbërje të vet gratë në pozita vendimarrëse ,asambleiste përfaqësues të ojq të grave dhe përfaqësues të komuniteteve tjera.

Parimet kryesore të **cilat janë marrë parasysh në hartimin e këtij plani janë:**

- ✓ Të drejtat e grave janë dhe të drejtat e njeriut,
- ✓ Barazia gjinore është kontribuues i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm të vendit,
- ✓ Komuna duhet të posedojnë kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave,
- ✓ Komuna duhet të përfshijë integrimin gjinor në politikat e saj
- ✓ Komuna duhet të merr parasysh nevojat e grave dhe sidomos grave te komuniteteve tjera

## IV Problemet e **identifikuara deri tani që kanë shkaktuar pabarazinë gjinore në Komunën e Fushe Kosoves**

*Problemi* kryesor në fushën e fuqizimit ekonomik dhe mirëqenies sociale është ***prania e pabarazive dhe përjashtimi socio-ekonomik***. Ky problem shkaktohet nga një mori faktorësh, të diskutuar në vijim.

- Mungesa e **integrimit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore.**
- Duke mos **qenë të përfaqësuara në proceset vendimmarrëse, kërkesat dhe nevojat e tyre specifike nuk merren parasysh,** investohet më pak në përmirësimin e kushteve që ndihmojnë gratë (për shembull në rrugë lokale dhe furnizim me ujë) dhe në sektorët me potencial për punësimin e grave.
- Në **mungesë të institucioneve për përkujdesjen e fëmijëve deri në moshën 5 vjeçare, posaçërisht për gratë që jetojnë në** fshatra, **gratë detyrohen të qëndrojnë në shtëpi.** Mungesa e institucioneve për kujdesjen e fëmijëve pas mësimit, paraqitet si pengesë, posaçërisht për familjet me të ardhura të ulëta, që nuk kanë mundësi të përballojnë koston në institucione private.

- **Mungesa e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, mbetet sfidë në Kosovë.** Institucionet e Kosovës vazhdojnë ndër vite të sfidohen me mungesën e raportimit dhe analizës së statistikave nga perspektiva gjinore

- **Diskriminimi gjinor** evidentohet në punësim dhe avancimin profesional,mungesa e infrastrukturës dhe e sigurisë i kontribuon pozitës së margjinalizuar të vajzave dhe grave

- Grate **e komuniteteve tjera e sidomos ato te komuniteteve rom, ashkali,egjiptian** ende ballafaqohen me martesat e hershme dhe ka mungesë te vetedijesimit dhe ngritjes se kapaciteteve te ketyre grave.

- Mungesa e masave **afirmative** te cilat do te ndikonin pozitivisht në poziten e grave.

V Fushat në të cilat **ka fokusin ky Plan i Veprimit.**

Fusha A e veprimit

Fuqizimi ekonomik **dhe mirëqenia sociale**

Objektivi 1 **Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale** . Ky objektiv ka për qëllim të siguroj ,avancoj fuqizimin ekonomik dhe përmirësim të mirëqenies sociale të grave, rrit aktivizimin e grave në tregun e punës dhe shkallën e punësimit të tyre gjithashtu te siguroje që gratë kanë qasje të barabartë në të drejta, burime dhe shërbime.

Fusha B e veprimit

Avancimi i barazise gjinore

Objektivi 2 Avancimin e barazisë gjinore, dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore .

Ky objektiv synon të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore duke theksuar të drejtën themelore për mundësi të papenguar në realizimin e kapaciteteve dhe potencialeve të vajzave dhe grave, eliminimin e praktikave diskriminuese shoqërore (në bazë te

gjinisë, etnisë, moshës, dhe aftësisë) dhe krijimin e politikave të cilat përkrahin dhe avancojnë pjesëmarrje të barabartë të grupeve të margjinalizuara

Fusha C e veprimit

Vendimmarrja

**Objektivi 3 Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje,** Avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje **garantues i arritjes së barazisë gjinore**

Ky objektiv ka për qëllim të siguroj, përmirësoj dhe rris vendimmarrjen duke promovuar specifikisht barazinë gjinore dhe integruar perspektivën gjinore në politika komunale, fuqizuar mekanizmat institucional për barazi gjinore,

## VI. Kohëzgjatja e zbatimit të planit dhe institucionet e përfshira

Kohëzgjatja e planit të veprimit është i paraparë si plan që do të zbatohet në periudhën 3 vjeçare 2023-2025

Institucionet zbatuese dhe partnere

Institucioni kryesor zbatues për këtë plan veprimi është Komuna e Fushe Kosoves me dikasterët e saj si dhe Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të kësaj Komune, këto organe kanë për detyrë që të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë pa marrë parasysh përkatësinë gjinore fetare etnike moshë e racë ti promovojë vlerat për të drejtat e njeriut si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi realizimin e tyre.
Të gjitha aktivitetet do të mbështeten nga grupi i grave asambleiste në kuadër të Kuvendit Komunal të kësaj Komune
Ndër institucionet e tjera të përshira në zbatimin e elementeve të caktuara të këtij plani janë; Qendra për Punë Sociale , Shkollat, Zyra për punësim ,Organizatat Joqeveritare dhe persona tjerë juridik që veprojnë në Komunën e Fushe Kosoves .

## VII Aktivitetet për zbatim

Arritja e objektivave të parapara në ketë plan kryhet përmes zbërthimit të tyre në aktivitetet përkatëse të cilat janë renditur sipas shtyllave të përcaktuara në planin kombëtar për barazi gjinore dhe gjithashtu kanë edhe afatin kohor mbrenda të cilës do të duhet të përfundojnë.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si me poshtë

**Fuqizimi ekonomik**

**Objektivi qendror . Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale**

- Aktivitete promovuese për të drejtat në punë ( fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese për publikun e gjerë me theks të vecant gratë te cilat janë te gatshme për punë ,këtu mund të hyjnë edhe trajnimet dhe sesionet informuese)
- Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale
- Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit
- Ndërmarrja e masave afirmative në punësim
- Ngritja e kapaciteteve për rintegrimin gjinor në politika publike, në nivelin lokal
- Monitorimi i politikave komunale me qëllim të përfshirjes së prespektivës gjinore .
- Integrimi i prespektives gjinore / marrja e masave afirmative (masa afirmative për ndarjen e banesave sociale përmes bonus banimit apo ngjajshem )
- Promovimi i grave të suksesshme në profesione të ndryshme.
- Përfshirja e përspektivës gjinore në panairet ekzistuese
- Informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet Komunale

- Organizimi i punëtorive nje ditore me gratë e interesuara për të filluar biznese

**Avancimi i barazisë gjinore.**

**Objektivi qendror** : Avancimi i barazisë gjinore përmes zhdukjes se pabarazive dhe stereotipeve gjinore dhe zhvillimit profesional në Arsim Shkence, Kulture ,Rini dhe Sport

Aktivitete

- Aktivitete vetëdijesuese për nevoja për arsimimin e vajzave (për nevojen për një grua te arsimuar)
- Krijimi i mundësive për gratë për avancim profesional dhe në karrierë në institucionet publike
- Analizimi i buxhetit me përspektivë gjinore
- Aktivitete vetëdijesuese për shendetin riprodhues dhe pastnatal
- Organizimi i takimeve me gra dhe vajza te komunitetit Rom ,Ashkali, Egjiptian me theks të vecantë tek shëndeti riprodhues ,kultura shendetësore dhe martesat e hershme

**Vendimarrja**

**Objektivi qendror Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje dhe qasja ne drejtesi**

Aktivitete

- Ndërrmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e ligjit per barazi gjinore në pozitat vendimmarrëse
- Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe vetëdijesuese mbi barazinë gjinore për grupin e grave asambleiste të Asamblesë Komunale
- ngritja kapacitetesh për asambleistet e Asambles Komunale dhe fushata për integrimin e qëndrueshëm të grave të kthyera nga zonat e luftës.
- fushata vetëdijësuese për qytetarët për sherbimet juridike falas dhe për dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore

- mbulimi i shpenzimeve emergjente për viktimat e dhunës në familje
- fushata vetëdijësuese për të drejtat në trashëgimi dhe pronë .

## VIII. Plani i monitorimit dhe i vleresimit .

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij plani obligohet, Komuna e Fushe Kosoves dhe dikasteret e saj të përmendur në ketë dokument.

Akteret përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve si dhe ata partnere në zbatim duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteteve të përcaktuara

shtojca

Tabela e aktiviteteve për realizimin e planit të veprimit.

# PLANI I VEPRIMIT: 2023-2025

| 1. | Fusha e veprimit : Fuqizimi ekonomik<br>Objektivi qendror: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar në dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti<br>Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| 1.1 | Aktivitete promovuese për të drejtat në punë ( fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese për publikun e gjere me theks te veçant gratë te cilat jane te gatshme për punë ,ketu mund te hyjne edhe trajnimet dhe sesionet informuese) | 2023-2025 | 2.000 | 2.000 | 2.000 | Buxheti Komunal | Zyra për Barazi Gjinore<br>Zyra për informim, OJQ | Publiku i informuar përgjate 5 fushatave informuese | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 1.2. | Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale | 2023-2025 | 1.200 | 1.200 | 1.200 | Buxheti Komunal | DPMS , Drejtoria për Arsim | 6 fëmijë të subvencionuar nga 2 në vit-2 | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë PKBGJ |
| 1.4 | Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në | 2023-2025 | 0 | 0 | 0 | Nuk ka kosto | DPMS ,QPS-të Ministria e Financave, | Përfshirja e përfituesve të Ndihmës Sociale në | PKBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | programet e punësimit | | | | | shtesë | **Punës dhe Transfereve.** | programe të punësimit | |
| 1.5 | Ndërmarrja e masave afirmative ne punësim | 2023-2025 | 0 | 0 | 0 | Nuk ka kosto shtese | **Zyra ligjore e Komunes , Kuvendi Komunal** | 2 masa afirmative ne vitin 2023 dhe 2025 | PKBGJ, LBGJ |
| 1.6 | Ngritja e kapaciteteve për integrimin gjinor në politika publike, në nivelin lokal | 2023-2025 | 0 | 2.000 | 2.000 | Buxheti komunal dhe donatoret | **ZBGJ, Kuvendi Komunal** | Së paku 20 asambleist/e komunale në 3 vite te trajnuar | PKBGJ, LBGJ |
| 1.8 | Monitorimi i politikave komunale me qëllim të përfshirjes së përspektivës gjinore | 2023-2025 | 0 | 0 | 0 | Nuk ka kosto shtesë | **Zyrtaret komunal per hartimin e politikave dhe ZBGJ** | Raportet e monitorimit | LBGJ |
| 1.9 | Integrimi i perspektivës gjinore/ marrja e masave afirmative për ndarjen e banesave sociale | 2023-2025 | 0 | 0 | 0 | Nuk ka kosto shtesë | **DPMS** | Së paku nje mase e tille e ndërmarre dhe 1-2 banesa te ndara | PKBGJ |
| 1.10 | Promovimi i grave te suksesshme ne profesione të ndryshme | 2023-2025 | 1.000 | 1.500 | 1.500 | Buxheti komunal | **Të gjitha Drejtorit.** | Së paku nje aktivitet promovues në vit | PKBGJ LBGJ |
| 1.11 | Përfshirja e perspektivës gjinore në panairet ekzistuese | 2023-2025 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Nuk ka kosto shtesë | **Drejtoria për Bujqësi, Drejtoria për Kultur,Rini Sport.** | Panairet me përspektivë gjinore | LBGJ |
| 1.12 | Informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programet Komunale | 2023 | 100 | 100 | 100 | Buxheti komunal | Zyra per informim, Drejtoria per bujqesi, OJQ dhe organizatat nderkombetare | Së paku nje takim informues i mbajtur | LBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.13 | Organizimi i punetorive nje ditore me gratë e interesuara të fillojnë një biznes dhe gratë sipërmarrëse<br><br>Rrjetizimi i grave në biznes | 2023 | 1.500 | 1.500 | 1.500 | Buxheti komunal | Zyra per informim, Drejtoria per zhvillim ekonomik dhe financa ,OJQ | Nje punetori e organizuar me 25 - 30 pjesemarrese. | PKBGJ |
| | *Buxheti ne total per vite* | | 6.800 | 9,300 | 9,300 | | | | |
| | *Buxheti total per tre vite* | | *25,400 €* | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| .2 | **Fusha e veprimit : Avancimi i barazisë gjinore**<br>**Objektivi qendror: Avancimi i barazisë gjinore dhe zhdukja e pabarazive dhe stereotipeve gjinore** | | | | | | | | |
| **Nr.** | **Veprimi/Aktiviteti** | **Afati i fundit** | **Buxheti** | | | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Referenca në dokumente** |
| | | | **Viti 2023** | **Viti 2024** | **Viti 2025** | | | | |
| 2.1 | Aktivitete vetëdijesuese për nevojen për nje grua te arsimuar | 2023-2025 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Buxheti komunal | Drejtoria per arsim ZBGJ | Broshura te shtypura, billborde, se paku nje takim informues. | LBGJ PKBGJ |
| 2.2 | Krijimi i mundësive për gratë për avancim profesional dhe në karrierë në institucionet publike komunale | 2023 - 2025 | 0 | 0 | 0 | Nuk ka kosto shtesë | **Zyra ligjore ZBGJ** | Se paku nje politik komunale e hartuar për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngacmimi seksual | Ligji për Mrojtjen nga diskriminimi |
| 2.3 | Analiza të buxhetit me perspektivë gjinore | 2023-2025 | 0 | 0 | 300.00 | Buxheti Komunal | **Drejtoria per financa ,ZBGJ** | Analiza e publikuar | Ligji për Barazi Gjinore |
| | | | | | | | | | |
| 2.4 | Aktivitete vetedijesuese per shëndetin riprodhues dhe pastnatal | 2023-2025 | 1.500 | 1.500 | 1.500 | Buxheti Komunal | Drejtoria per shendetesi ,QKMF dhe ZBGJ | Se paku nje fushat në vit | PKBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.5 | Aktivitete vetedijesuese, për komunitetin Rom, Ashkali, Egjiptian me theks te veçantë tek shëndeti riprodhues, kultura shëndetësore dhe martesat e hershme | 2023-2025 | 1.500 | 1.500 | 1.500 | Buxheti Komunal | Drejtoria per shëndetesi dhe ZBGJ , Qendra për punë sociale. | Nje fushatë në vit | PKBGJ |
| 2.6. | Organizimi dhe sigurimi i shërbimeve psikologjike në sistemin arsimore te komunës | | | | | | Drejtoria për Arsim | | Udhëzim Administrativ MASHT Nr.34/2014 |
| 2..7 | Totali i buxhetit për vite | | 4,000 | 4,000 | 4,300 | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | Buxheti total për tre vite | 12,300 € | | | | | | | |
| 3 | Fusha e veprimit : Vendimarrja<br>Objektivi qendror: Avancimi i realizimit te të drejtave në vendimarrje dhe qasja në drejtesi | | | | | | | | |
| Nr. | Veprimi | Afati i fundit | Viti 2020<br>Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti (Output) | Referenca në dokumente |
| | | | | | | | | | |
| | Ndërmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore në pozitat vendimmarrëse | I vazhdueshëm | 200.00 | 200.00 | 200.00 | Buxheti komunal Financimi i donatorëve | Kuvendi Komunal | Numri i vendimeve të masave afirmative të ndërmarra | Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës PKBGJ |
| 3.1 | Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe vetëdijësuese mbi barazinë gjinore për grupin e | I vazhdueshë | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Buxheti komunal Financimi | ZBGJ , Gratë asambleiste Shoqëria civile, | Numri i takimeve të mbajtura | Ligji për Barazi Gjinore i |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | grave deputete të asambleve komunale dhe nivelit qendror | m | | | | i donatorëv e | donatorë | | Kosovës PKBGJ |
| 3.2 | Ngritja e kapaciteteve te asambleisteve komunale dhe grave tjera për integrimin e qëndrueshem te grave te kthyera nga zonat e luftes | 2023-2025 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Buxheti komunal Financimi i donatorëv e | ZBGJ, Gratë asambleiste Shoqëria civile, donatorë | Kapacitete te ngritura për integrimin e qëndrueshem. | |
| 3.3 | Fushata vetëdijesuese me qytetaret, për sherbimet juridike falas dhe për dhunen në familje dhe dhunen ne baza gjinore | 2023-2025 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Buxheti komunal Financimi i donatorëv e | ZBGJ, Gratë asambleiste Shoqëria civile, donatorë | Nr i broshurave tryzave dhe diskutimeve, nje fushatë në vit | PKBGJ |
| 3.4 | Mbulimi i shpenzimeve emergjente për viktimat e dhunes në familje dhe fëmijëve . | 2023-2025 | 500 | 500 | 500 | Buxheti komunal | Drejtoria per mireqenje sociale | Nje shume totale në vit për Qendren për Punë Sociale, stacionin policor ku qëndron viktima. | PKBGJ Strategjia për mbrojtjen nga dhuna ne familje |
| 3.5 | Psikologu Klinik | | | | | | Drejtoria pëe mirëqenje sociale -QPS | | Ligji për shërbimet sociale dhe familjare. |
| | Fuqizimi i mekanizmit kundër dhunes familje përmes trajnimeve,fushatave promovuese. | | 1.000 | 500 | 500 | | Anëtaret e Mekanizmit kunër dhunës familje. | | |
| | Fushata vetedijesuese për të drejtat | 2023-2025 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | Buxheti komunal | ZBGJ , Gratë asambleiste Shoqëria civile, donatorë | Nr i billbordeve posterave dhe tryezave te mbajtura | UA per regjistrim in e prones se |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | në trashëgimi dhe pronë | | | | | | | | përbashket.<br>Ligji për trashëgiminë. |
| | Totali i buxhetit për vite | | 5,700 | 5,200 | 5,200 | | | | |
| | Buxheti total për tre vite | 16,100 € | | | | | | | |
| | Buxheti total i plani të veprimit për tre vite | 53,800 € | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

185
04.08.2022

**Datë: 04.08.2022**

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.07.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 603, të datës 18.07.2022, të paraqitur për shqyrtim nga Kordinatorja e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, paragrafi 1.2, të Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 05/l-020, (Gazeta Zyrtare Nr. 16/2015), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

**V E N D I M**

**Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës**

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës.

2. Projekt-Planit i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për barazi gjinore.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Planit i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Ali Ismajli**

726
17.08.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

**Datë: 17.08.2022**

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 185 të datës 04.08.2022, bën këtë:

**NJOFTIM**
**PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK**

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik është i hapur nga data 17.08.2022-30.08.2022 për: "Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025 në Komunën e Fushë-Kosovës".

Për sqarime dhe konsultime tjera, lidhur me 'Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025 në Komunën e Fushë-Kosovës', mund të drejtoheni në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, te Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore kati i parë, Zyra e Kuvendit kati përdhesë dhe Zyra për Informim Publik, kati i parë.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datën: **29.08.2022, në orën 10:00h,** në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës. Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Përshëndetje!**

**Kryetari i Komunës**
**Burim Berisha**

292
18.05.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/ MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË**

Datë: 18.05.2022

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit Nr.434 të datës 11.05.2022, paraqitur nga Koordinatorja për Barazi Gjinore dhe Mundësi te Barabarta, bazuar në nenin 58, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 43, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr.98 të datës 17.12.2012, mori:

VENDIM

1. Formohet Grupi Punues për përgatitjen e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë Kosovës, në përbërje prej anëtareve si në vijim:

1.1 Lindita Dervisholli Prebreza- Koordinatore e NDNJBGJ;

1.2 Shemsie Fetahu -Drejtore e Shkollës Fillore e Mesme e Ulët' Lismiri';

1.3 Hasime Qyqalla- Avokate Publike;

1.4 Aida Alimi-Asamblesiste PDK;

1.5 Vjollca Konjusha- Asambleiste LDK;

1.6 Eglantina Azemi-Asambleiste LVV;

1.7 Qëndresa Ademi- Asambleiste IFKEA;

1.8 Elmie Graiqevci Zymberi-Shefe e Drejtorisë së Arsimit;

1.9 Mimoza Kolshi - Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

1.10.Antigona Sahit - Shefe e Drejtorisë së Planifikimit Urban;

1.11.Valentina Kolshi - Udhëheqëse e Personelit;

1.12.Florentina Pacolli Ahmeti - Certifikuese ;

1.13.Shqipe Islami – Zyrtare për komunikim me media ,Zyra e Kryetarit te Komunës;

1.14.Hava Avdullahu - Përfaqësuese e Organizatës jo Qeveritare "FLORI";

1.15.Hajrije Berisha – Përfaqësuese e Organizatës jo Qeveritare Fëmijët pa kujdes prindëror- OFAP.

2.Detyrë dhe përgjegjësi e grupit punues është hartimi i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore te Komunës së Fushë Kosovës konform dispozitave ligjore në fuqi.

3.Grupi Punues i formuar sipas këtij vendimi për punën e kryer i raporton me shkrim Kryetarit të Komunës.

4.Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

Akti i dorëzohet:
1x Kryetarit të Komunës
1x KNJDNJBGJ
1x Anëtarëve të grupit
1x Arkivit

Kryetari i Komunës
Burim Berisha

603
18.07.2022

*REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA*
*REPUBLIC OF KOSOVA*

*KOMUNA FUSHË –KOSOVË / OPŠTINA KOSOVO-POLJE*
*MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË , KOSOVO POLJE*

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| PËR (ZA) TO: | | Komiteti për Politikë dhe Financa<br>Komiteti për Komunitete<br>Kuvendin | | | |
| CC: | | | | | |
| PËRMES(PREKO)THROUCH | | Burim Berisha Kryetar i Komunës | | | |
| NGA (OD) FROM | | Lindita Dervisholli Prebreza Koordinatore e NDNJ,ZBGJ | | | |
| TEMA (SUBJEKAT) SUBJECT | | Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2023-2025 | | | |
| Numri i Zyrës:<br>Br. Kancalarije:<br>Room No: | 25 | Lokali:<br>Kucni:<br>Extension: | | Data:<br>Datum:<br>Date: | 07.07.2022 |

Të nderuar/a

**Hartimi i Planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore të Komunës së Fushë Kosovës është obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore 05/L -020** specifikisht, Neni 5 , paragrafi 1.2 i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore.

Propozoj, aprovimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore ku përmes aktiviteteve të planifikuar do të ndikohet në promovimin e barazisë gjinore, si dhe në rrritjen e përformances komunale.

Të gjitha aktivitetet janë në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 - 2024 , i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me daten 23. maj 2020 nr vendimit 01/34

Me respekt!